

Konferenca e 18-të Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Konkurrencës në Berlin

Në organizim të Autoritetit Gjerman për Mbrojtjen e Konkurrencës „Bundeskartellamt”, në periudhën prej 15-17 mars në Berlin, u mbajt Konferenca e 18-të Ndërkombëtare për Konkurrencë, e cila tradicionalisht mbahet çdo vit dhe paraqet një nga ngjarjet dhe takimet më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së konkurrencës.



Tema e konferencës së këtij viti ishin aspektet dhe sfidat e ndryshme në zbatimin e politikës për mbrojtjen e konkurrencës që dalin nga digjitalizimi dhe globalizimi i tregut. Fjalë hyrëse në konferencë kishte z. Andreas Mundt- Kryetar i Autoritetit Gjerman për Konkurrencë, Ministrja federale e Ekonomisë dhe Energjetikës z-nj. Brigitte Zypries, z-nj. Margrethe Vestager- Komisare Evropiane për Konkurrencë, si dhe Dr Frank Appel, CEO Deutsche Post. Në këtë konferencë morën

pjesë përfaqësues më të lartë të autoriteteve të mbrojtjes së konkurrencës nga e gjithë bota, gjyqtarë nga gjykatat evropiane, jurist anti-trust, profesorë, politikanë, përfaqësueses të kompanive ndërkombëtare etj. Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësuesit e Komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës nga Republika e Maqedonisë.

Në kuadër të kësaj konference u mbajtën edhe disa panele me temat e mëposhtme:
- Kush sjell risitë dhe investimet?- (Size or competition-What drives innovation and investment?); platformat dhe rrjetet – nëse organet për mbrojtjen e konkurrencës kanë qasje të drejtë?-(Platforms, networks, big data – Do competition authorities get it right?); nëse teoritë ekonomike janë të gatshme për botën e digjitalizuar?- (Economic theory – Ready for the digital world?), dhe praktika bashkëkohore në fushën e kartelave - Dje histori suksesi – nesër Dështime? (Modern cartel enforcement-Yesterdays success stories-tomorrow's failures?).